



PA U ZBARDHUR BANJSKA, DIALOGU I PAIMAGJINUESHËM



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se dialogu nuk mund të vazhdojë sikur nuk ka ndodhur

asgjë në Banjskë. Analistët thonë se ngjarja e ka dëmtuar në masë të madhe procesin edhe ashtu të

vështirë të dialogut Kosovë - Serbi dhe nuk presin që ai të vazhdojë në të njëjtin format

AKTUALE



BEGAJ, VON DER LEYENIT: BE-ja TA NDËSHKOJË SERBINË PËR SULMIN TERRORIST NË VERI TË KOSOVËS F. 3

BUJAR OSMANI: NIKOLLA GRUEVSKI ËSHTË MIRË TË KTHEHET NË MAQEDONINË E VERIUT F. 2

KFOR-I PËRFORCOHET ME PJESËTARË RUMUNË F. 6

EKONOMI



KOSOVA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR PROJEKTE ZHVILLIMORE NË VLERË PREJ 79 MILIONË EUROSH F. 7

BËHEN ME PAGESË QESËT E PLASTIKËS NË KOSOVË, SHOQATA E KONSUMATORËVE KUNDËRSHTON VENDIMIN F. 7

SPORT



KOSOVA MUND TA KETË NJË MUNDËSI TJETËR PËR KUALIFIKIM NË 'EURO 2024' F. 10

NISIN HETIMET PËR HELMIMIN NË MALISHEVË, AUV GJEN PRODUKTE 'PA ORIGJINË' I FAQE 3



NETANYAHU MBLEDH KABINETIN QEVERITAR, ZOTOHET SE DO TA 'SHKATËRROJË' HAMASIN I FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Netanyahu mbledh kabinetin qeveritar, zotohet se do ta "shkatërrojë" Hamasin

JERUSALEM, 15 TETOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, e ka mbledhur kabinetin emergjent qeveritar për herë të parë të dielën, duke thënë se uniteti kombëtar i shpërfaqur ditët e fundit ka dërguar mesazh brenda dhe jashtë shtetit. Takimi është mbajtur në selinë e ushtrisë në Tel Aviv dhe ka nisur me një minutë heshtje për t'i nderuar 1 300 izraelitët e vrarë nga grupi militant Hamas më 7 tetor. Duke e mirëpritur ligjvënësin opozitar, Benny Gantz, i cili i është bashkuar qeverisë bashkë me disa anëtarë të partisë, Netanyahu ka thënë se të gjithë ministrat janë duke punuar "pa orar, në një front të përbashkët".

"Hamas ka menduar se do të na shkatërrojë. Jemi ne ata që do ta shkatërrojmë Hamasin", ka thënë Netanyahu, duke shtuar se shfaqja e unitetit dërgon mesazh të "kombi, armiku dhe bota". Ushtria izraelite është duke u përgatitur për një ofensivë në Gaza për ta luftuar Hamasin. Ajo i ka urdhëruar mbi 1 milion palestinezë që të shpërngulen nga veriu në jug të Gazës. Kombet e Bashkuara i kanë kritikuar urdhrat për evakuime dhe kanë paralajmëruar për katastrofë humanitare. Ushtria izraelite ka bombarduar shënjestra të Hamasit në Gaza, prej sulmeve të pashembullta të grupit militant ndaj civileve izraelitë në fundjavën e kaluar.



Spitalet në Gaza paralajmërojnë se mijëra pacientë mund të vdesin, mungojnë furnizimet

GAZA, 15 TETOR - Mjekët në Gaza kanë paralajmëruar se mijëra persona mund të vdesin në spitalet e mbushura me persona të plagosur pasi ka nisur të vërehet mungesa e produkteve bazike. Palestinezët nuk kanë qasje në ujë dhe ushqim, me një vendim të qeverisë izraelite, pas sulmeve të grupit militant Hamas në tokën izraelite më 7 tetor. Spitalet në Gaza pritet të mbesin pa naftë për gjeneratorë brenda dy ditëve dhe kështu do të rrezikohet jeta e mijëra pacientëve, sipas agjencive të Kombeve të Bashkuara. Në spitalin Nasser në qytetëzën jugore Khan Younis dhomat për kujdes intensiv janë të mbushura me pacientë të plagosur, shumica prej tyre fëmijë nën moshën trevjeçare. Qindra njerëz me plagë të rënda janë në spital, ku nafta do të mbarojë deri në fund të ditës së hënë, ka thënë mjeku Mohammed Qandeel, për agjencinë e lajmeve AP. "Janë 35 pacientë në dhomat për



kujdes intensiv që kërkojnë ventilatorë dhe 60 të tjerë në dializë. Nëse mbesim pa naftë, kjo nënkupton që i gjithë sistemi ndalet", ka thënë ai, derisa fëmijët janë dëgjuar duke vajtuar në prapavijë. "Të gjithë pacientët rrezikojnë të

vdesin për shkak të mungesës së energjisë". Mjeku tjetër Hussam Abu Safiya, në sektorin e pediatriisë në spitalin Kamal Adwa, në veri të Gazës, ka thënë se nuk është evakuuar pavarësisht urdhrat të Izraelit. Ai ka thënë se në spital

janë shtatë foshnja të sapolindura në dhomat për kujdes intensiv. "Ne nuk mund të evakohemi, kjo do të thotë vdekje për ato dhe pacientët e tjerë". Numri i pacientëve sa shkon e rritet me plagë e djegie të thella. "Është e frikshme", ka

thënë ai. Gaza veçse ka qenë duke u përballur me krizë humanitare për shkak të mungesës së ujit dhe ilaçeve për shkak të rrethimit izraelit. Izraeli u ka kërkuar mbi 1 milion palestinezëve - pothuajse gjysmës së popullsisë - që të shpërngulen në jug të Gazës. Ushtria ka thënë se po tenton t'i largojë civilët nga zonat ku do ta luftojë Hamasin. Hamasi, në anën tjetër, u ka kërkuar banorëve të qëndrojnë në shtëpitë e tyre. Ushtria izraelite ka publikuar fotografi që, sipas saj, tregojnë se Hamasi i ka bllokuar rrugët që çojnë në jug të Gazës. Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët është shprehur shumë e shqetësuar për palestinezët që nuk mund të largohen sikurse "gratë shtatzëna, fëmijët, personat me nevoja të veçanta dhe të moshuarit". Kjo agjenci i ka bërë thirrje Izraelit t'i mos sulmojë civilët, spitalet, shkollat, klinikat dhe lokacionet e OKB-së.

Bujar Osmani: Nikolla Gruevski është mirë të kthehet në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 15 TETOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, ka deklaruar të dielën se ish-kryeministri i arratisur, Nikolla Gruevski, është mirë të kthehet në Maqedoni të Veriut nga Hungaria pasi, sipas Osmanit, bëhet fjalë për një njeri që di shumëçka për vendin, por që ndodhet në shtet tjetër. "Nga pikëpamja politike, është një çështje e

cila e di se do të abuzohet, por nga pikëpamja e sigurisë nuk është aspak e mençur që në duart e një shteti tjetër të jetë një njeri që dhjetë vjet ka qenë kryeministër dhe i cili i ka të gjitha informacionet shtetërore", ka thënë Osmani për "Televizionin 21". Ish-kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski është arratisur në Hungari në vitin 2018, pas ndjekjes nga

organet gjyqësore maqedonase për shpërdorim të detyrës zyrtare. Ai është dënua me 14 vjet burgim për gjashtë vepra penale, ndërsa disa procese të tjera janë duke u zhvilluar ende. "Është mirë që ai të jetë këtu dhe të merret me proceset gjyqësore që zhvillohen ndaj tij. Kjo do të ishte zgjidhja më e mirë", ka deklaruar Osmani.



Nisin hetimet për helmimin në Malishevë, AUV gjen produkte 'pa origjinë'

Ka shkuar mbi 200 numri i personave të helmuar nga ushqimi në Malishevë, në një lokal, por situata është nën kontroll dhe po monitorohet nga organet kompetente. Disa nga të helmuarit janë udhëzuar për QKUK në Prishtinë dhe në Spitalin e Prizrenit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

MALISHEVË, 15 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se gjendja e të helmuarve në komunën e Malishevës është stabile. Të premtën është raportuar për një rast helmimi në këtë komunë, por ende nuk dihet shkaku i saktë i sëmurjes së dhjetëra qytetarëve. Deri më tani numri i të helmuarve ka shkuar mbi 200.

Ministri Vitia ka thënë se inspektoratet dhe organet ligjzbatuese janë në terren dhe kanë marrë të gjitha të dhënat lidhur me rastin, burimin dhe shkahun e helmimit.

Drejtori i Shëndetësisë në komunën e Malishevës, Hajdin Berisha, ka thënë se helmimi dyshohet të jetë bërë me

ushqim "në një biznes në Malishevë".

Zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Lamir Thaçi, ka thënë se agjencia ka kryer inspektim në biznesin e dyshuar. "Gjendja e përgjithshme sanitare - higjienike - ka qenë e nivelit jo të mirë. Ky vlerësim është bërë nga ekipi inspektues. E dyta, nuk kanë pasur libreza sanitare punonjësit e atij lokali që, sipas ligjit, kërkohet t'i kenë. Nuk ka pasur të kryer dezinfektim, deratizim dhe dezinsertime, që përsëri është kriter. Po ashtu, aty janë gjetur disa produkte që ne i quajmë pa origjinë, nuk kanë pasur dokumentacion mbështetës për t'u ditur origjina e tyre. Ka pasur produkte që janë gatuar brenda asaj kuzhine, dhe këto të gjitha janë fakte që



do t'i evidentojmë në proces dhe më pas organet e tjera do t'i vlerësojnë", ka thënë ai. Ai ka theksuar se do të rriten inspektimet në bizneset që

përgatitin ushqime të shpejta, sepse aty regjistrohen rastet më të shpeshta të helmimit. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është përgjegjëse

për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të qytetarëve përmes sigurisë ushqimore që Kosova synon ta ketë sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Begaj, Von der Leyenit: BE-ja ta ndëshkojë Serbinë për sulmin terrorist në veri të Kosovës



TIRANË, 15 TETOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, i ka kërkuar presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, që BE-ja ta ndëshkojë Serbinë për sulmin terrorist të 24 shtatorit, ku mbeti i vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. Gjatë takimit të zhvilluar të dielën në Presidencë, Begaj i ka kërkuar shëfës së KE-së që Evropa të mbajë qëndrim ndaj Serbisë duke marrë masa ndaj saj. "Presidenti Begaj shfrytëzoi këtë takim për t'i përsëritur qëndrimet e Bashkimit Evropian për stabilizimin e paqes në rajon duke kërkuar që të ndëshkohet sulmi terrorist serb i 24 shtatorit ndaj një vendi

sovran siç është Kosova dhe destabilizim të të gjithë rajonit", thuhet në njoftimin e Presidencës pas takimit me Von der Leyen.

Po sipas njoftimit të Presidencës, bëhet me dije se është diskutuar edhe mbi procesin e integritimit në Bashkimin Evropian të Shqipërisë, situatën e sigurisë në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor dhe rreth bashkëpunimit rajonal në optikën e Procesit të Berlinit. "Shqipëria është e vendosur në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian", nënvizoi presidenti Begaj në këtë takim.

Duke u ndalur në situatën kritike të sigurisë që po kalojnë Evropa dhe Ballkani Perëndimor,

presidenti Begaj e siguroi zonjën Von der Leyen se "Shqipëria vazhdon të mbështesë e të jetë e linjësuar me politikat e jashtme dhe ato të sigurisë së BE-së".

Duke e cilësuar si ngjarje historike mbajtjen e Samitit të liderëve të Procesit të Berlinit për herë të parë në një vend të Ballkanit Perëndimor të martën në Tiranë, presidenti Begaj u shpreh se është "besimplotë se ky samit do të nxisë marrëdhënie më të mira midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe se do t'i ndërtojë shinat e duhura për krijimin e një tregu ekonomik të zonës, shina që do të zgjaten më pas drejt tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian".

Rreth 300 burra në Kosovë kanë përjetuar dhunë në familje gjatë këtij viti

PRISHTINË, 15 TETOR - Të paktën janë 295 burra që kanë përjetuar dhunë në familje deri në qershorin e këtij viti. Kosova nuk ka një qendër strehimore për burrat që përjetojnë dhunë, megjithatë premtimet e institucioneve janë se kjo do të ndryshojë.

Ministria e Drejtësisë konfirmoi për "KosovaPress" se komuna e Prishtinës është në kërkim të një lokacioni për

ndërtimin e kësaj qendre, por pa dhënë një afat se kur mund të jetë gati.

Kryetari i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNj), Bexhet Shala, ka deklaruar për "KosovaPress" se numri real i burrave që pësojnë dhunë është shumë më i madh por, sipas tij, për shkak të krenarisë, ata "nuk japin deklarata ose e paraqesin rastin vetëm

gojarisht".

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, në vitin 2022 janë raportuar 2 764 raste të dhunës në familje, ku prej tyre 2 294 kanë qenë viktime femra, ndërsa 523 meshkuj. Ndërsa për këtë vit, gjatë periudhës janar-qershor, janë raportuar 1 268 raste të dhunës në familje, ku nga këto raste viktime kanë qenë 1 324, viktime femra 1 029 raste dhe viktime meshkuj 295.





Pa u zbardhur Banjska, dialogu i paimagjinueshëm

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se dialogu nuk mund të vazhdojë sikur nuk ka ndodhur asgjë në Banjskë. Analistët thonë se ngjarja e ka dëmtuar në masë të madhe procesin edhe ashtu të vështirë të dialogut Kosovë - Serbi dhe nuk presin që ai të vazhdojë në të njëjtin format

PRISHTINË, 15 TETOR - Nga sulmi i 24 shtatorit në Banjskë flitet pak për bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë që i ndërmjetëson Bashkimi Evropian, përveç thirrjeve të bashkësisë ndërkombëtare që palët t'i kthehen këtij procesi. Rastin e parë ato e kanë pasur në samitin e Komunitetit Politik Evropian, që është zhvilluar më 5 tetor, në Granadë të Spanjës, por pa ndonjë rezultat. Të pranishëm atje kanë qenë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, edhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Derisa Vuçiqi, pa dhënë shumë detaje, ka thënë se është munduar t'ua shpjegojë përfaqësuesve evropianë qëndrimin e Serbisë, Osmani ka qenë më e drejtpërdrejtë. "Nuk ka asnjë arsye për t'u takuar përpara se të miratohen sanksionet kundër Vuçiqit. Së pari sanksionet dhe më pas mund të flasim për pjesën tjetër", ka thënë ajo. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se dialogu nuk mund të vazhdojë sikur nuk ka ndodhur asgjë në Banjskë. Kosova e akuzon Serbinë për sulmin në Banjskë të komunës

së Zveçanit, ku grupe të armatosura kanë sulmuar Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Në shkëmbimin e zjarrit që ka pasuar, janë vrarë edhe tre sulmues të nacionalitetit serb. Serbia ka mohuar se ka gisht dhe, ashtu si Kosova, ka nisur hetimet e veta të sulmit. Analistët thonë se ngjarja e ka dëmtuar në masë të madhe procesin edhe ashtu të vështirë të dialogut Kosovë - Serbi dhe nuk presin që ai të vazhdojë në të njëjtin format. Maja Pishçeviq, nga Këshilli Atlantik, thotë për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë" se, fillimisht, duhet të hetohet dhe të mësohet e vërteta pas sulmit në Banjskë. "Është e vështirë për mua të imagjinoj se palët mund t'i kthehen tani tryezës së bisedimeve. Ato takime, as në muajt e kaluar, as në rastet e mëparshme, nuk janë dukur mirë. Dy udhëheqësit nuk i kanë shtrënguar kurrë duart njëri-tjetrit. Dhe, a mund ta imagjinoj diçka të tillë të ndodhë tani?", pyetet Pishçeviq. Argumentet e ngjashme i mbron edhe Marina Vulloviq

nga Instituti Gjerman për Çështje Ndërkombëtare dhe të Sigurisë. Sipas saj, sulmi në Banjskë ka qenë i paparë që nga lufta në Kosovë më 1999. "Ne nuk i dimë motivet e vërteta të sulmit. Nuk e dimë se kush konkretisht e ka urdhëruar atë. E dimë se disa aktorë, së paku, e kanë marrë përgjegjësinë për të, por linja e komandës është ende një çështje e hapur. Financimi është një çështje e hapur, furnizimi me armë është gjithashtu një çështje e hapur", thotë Vulloviq për "Exposenë". Autoritetet në Kosovë e kanë etiketuar Millan Radoiçiqin si organizator të sulmit, por kanë thënë se ai ka vepruar me urdhër të aparatit shtetëror të Serbisë. Radoiçiq, i afërt me udhëheqësit serbë, e ka pranuar përgjegjësinë. Ai është marrë në pyetje nga Prokuroria serbe dhe është ngarkuar me disa vepra penale, përfshirë trafikim të armëve dhe shkakim të rrezikut të përgjithshëm. Vulloviq thotë se bashkësia ndërkombëtare duhet ta marrë shumë seriozisht rastin dhe t'i dërgojë sinjale të duhura politike Serbisë përpara se t'i ftojë palët në bisedime. Sipas

saj, shënjestër duhet të jetë regjimi serb, jo populli. "Konkretisht mendoj në masa ndëshkuese kundër Serbisë, që ta sinjalizojnë atë se sulmet e tilla nuk do të tolerohen. Edhe nëse nuk provohet përgjegjësi konkrete, ose nuk provohet ndonjë lidhje midis kreut të shtetit [serb] dhe sulmit parashtarak, duhet të ketë një lloj përgjegjësie politike për mbështetjen e atyre aktorëve që, në fakt, e kanë pranuar se qëndrojnë prapa sulmit", thotë Vulloviq. Vulloviq shton se tani i takon Bashkimit Evropian t'i bindë palët që t'i zbatojnë marrëveshjet për të cilat kanë rënë dakord. Por, sipas saj, formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk është prioritet tani, ashtu siç këmbëngul Serbia. Ajo thotë se sinjale të duhura për Kosovën që të kthehet në tryezën e bisedimeve do të duhej të ishin: ndëshkimi i Serbisë, siguria në veri dhe një zë më i unifikuar i BE-së kur bëhet fjalë për njohjen e shtetësisë së Kosovës. "Unë me të vërtetë nuk dua të besoj se dialogu ka vdekur, sepse e vetmja mënyrë për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme të situatës është përmes dialogut dhe pajtimit për një marrëveshje reciprokisht të dobishme. Ne e kemi një

marrëveshje të tillë [për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi] nga marsi i vitit 2023, që është arritur fillimisht në shkurt në Bruksel. Por, ajo nuk është zbatuar. Tani mendoj se Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja duhet ta gjejnë se si t'i bindin palët për ta zbatuar atë marrëveshje. Unë mendoj se gjëja kryesore këtu janë hapat me të cilët duhen filluar. Dhe sulmi në Banjskë na ka treguar vërtet se me cilët hapa duhet filluar", thotë Vulloviq. Pishçeviq, nga Këshilli Atlantik, thotë se një gjë është e sigurt: formati i deritashëm i dialogut duhet të ndryshojë. Përpara se palët të ulen në tryezën e bisedimeve, kurdo që të ulen, ato duhet t'i kenë të qarta disa gjëra: çka duan të arrijnë, cili është afati kohor, cilat janë rregullat, cilat janë ndëshkimet dhe cilat janë motivet. "Einstein ka thënë: nuk mund të vazhdoni t'i bëni të njëjtat gjëra dhe të prisni rezultate të ndryshme. Mendoj se, deri më tani, të gjithë e kanë kuptuar se kjo nuk është rruga përpara, sepse nuk ka vullnet politik. Nuk ka vullnet nga asnjëra anë - po flas për të dyja palët - për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Dhe viktimë e kësaj është populli", thotë Pishçeviq. E pyetur se ku mund të çojë situata aktuale, ajo përgjigjet:

Procesi i Berlinit dhe integrimi në BE, Bushati: Tani një mundësi e artë për vendet e Ballkanit

PRISHTINE, 15 TETOR - Në Shqipëri të hënën pritet të mbahet takimi i nivelit të lartë i Procesit të Berlinit, në të cilin do të marrin pjesë udhëheqësit e vendeve të Ballkanit perëndimor, kancelari gjerman Olaf Scholz dhe përfaqësues të lartë të Bashkimit Evropian. Presidenti francez Emmanuel Macron e ka shtyrë me disa orë mbërritjen në Shqipëri për shkak të një sulmi ekstremist ku u vra një mësues dhe situatës në Lindjen e Mesme. Ai nuk do të mund të marrë pjesë në takim, por do ta vazhdojë planin për vizitë zyrtare në Shqipëri. Ish-ministri i Jashtëm

shqiptar, Ditmir Bushati, thotë se pas agresionit rus në Ukrainë, zgjerimi i BE-së me vendet e rajonit është ngjitur në përparësitë e agjendës së Brukselit, dhe “vendet e Ballkanit nuk do të duhet ta shpërdorojnë këtë mundësi të artë”. Në një bisedë për “Zërin e Amerikës”, Bushati analizon ecurinë e Procesit të Berlinit dhe pritshmëritë nga ky proces dhe ai i integritimit evropian. “Së pari Procesi i Berlinit u iniciua nga Gjermania dhe kancelaria Merkel, në kushtet kur procesi i Zgjerimit kishte humbur magnetin e tij si transformues dhe demokratizues për vendet e

rajonit, dhe në kushtet kur vetë presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, deklaroi se nuk do të kishte zgjerim për 5 vitet e ardhshme. Pra, në një lloj mënyrë ishte si një ilaç antidepressiv për të gjitha vendet e rajonit. Por që në nisje nuk u konsiderua në asnjë moment si zëvendësues apo si alternativë ndaj procesit të anëtarësimit në BE. Mendoj se tre janë aspektet kryesore. Së pari në planin politik krijoi një barazi në të drejtat dhe detyrimet mes të gjitha palëve pjesëmarrëse. Pra qoftë dhe Kosova e Serbia u ulën me flamujt respektivë të tyre, pra

duke respektuar, le të themi, realitetet në rajon, duke krijuar një platformë më të gjerë komunikimi dhe bashkëveprimi, në kushtet kur ishte arritur dhe marrëveshja në Bruksel në vitin 2003. Së dyti, në planin ekonomik, përmes Procesit të Berlinit ne kemi disa zhvillime pozitive, qoftë me Zonën e Përbashkët Ekonomike, apo me Tregun e Përbashkët Rajonal, dhe me disa përpjekje shumë pozitive që u bënë nga të gjitha vendet, për krijimin e këtij lloji tregu në rajon, si paraprijëse ndaj anëtarësimit në Tregun e Përbashkët të BE-së. Së treti, në

planin shoqëror kemi dy nisma shumë të rëndësishme, të cilat synojnë afrimin e qytetarëve të vendeve të rajonit, më shumë me njëri-tjetrin dhe zbutjen e të gjitha paragjykimeve. Natyrisht, kur shohim nëntë vjet më pas, pritshmëritë nuk janë përmbushur plotësisht, sepse ka shumë çështje dhe sfida që do të duhet të adresohen duke nisur nga nevoja për një ndërlidhje më të mirë të këtij procesi me agjendën e anëtarësimit në BE, fuqizimin e demokracisë dhe një zbutje të hendekut zhvillimor mes vendeve tona dhe vendeve më të varfra të Bashkimit Evropian”, ka theksuar Bushati.



“Kjo është një pyetje fantastike dhe e tmerrshme, sepse vërtet mendoj se kjo mund të çojë në gjithçka. Por, nëse më pyesni nëse do të ketë luftë të re, kjo nuk mendoj se do të ndodhë. Edhe pse nuk më lejohet të mendoj se diçka është e pamundur në këtë pikë”. Pas sulmit në Banjskë, Serbia ka grumbulluar trupa ushtarake në kufi me Kosovën, gjë që është dënuar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat e kanë parë si “veprim shumë destabilizues”.

Megjithatë, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka bërë përpjekje ta sigurojë Perëndimin se nuk e ka ndërmend t’i urdhërojë forcat ushtarake ta kalojnë kufirin, duke thënë se kjo do të ishte kundërproduktive për aspiratat e Serbisë për t’iu bashkuar BE-së. Vuçiqi ka folur për gazetën “Financial Times”: “Pse kjo do të ishte e dobishme për Beogradin? Cila do të ishte ideja? Ta shkatërrojmë pozicionin tonë që e kemi ndërtnuar për një vit? Ta shkatërrojmë këtë brenda një

dite? Serbia nuk dëshiron luftë”. Përkundër këtyre garancive, disa zyrtarë thonë se situata në rajon ka potencial për t’u ndezur edhe me më të voglën shkëndijë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë këtë javë se ka rrezik në rritje të përsëritjes së sulmeve të dhunshme nga, siç është shprehur, “strukturat kriminale të Serbisë në Kosovë”. Duke folur në një forum në Mal të Zi, javën e kaluar, përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi,

Miroslav Lajçak, ka thënë se “duhet të punohet për normalizim dhe dialog, por nga ana tjetër kemi përshkallëzim. Nuk ka të ardhme evropiane pa marrëdhënie të mira në mes të Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë Lajçaku. Më datë 21 tetor në Prishtinë dhe në Beograd do të qëndrojnë përfaqësuesit e shteteve të QUINT-it, ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe Italisë, ashtu si dhe përfaqësues të BE-së, për të diskutuar çështjen e dialogut Kosovë - Serbi.

Kryeministri i Kosovës, Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Vuçiq, janë takuar për herë të fundit në Bruksel më 14 shtator, dhjetë ditë para sulmit në Banjskë. Pas Banjskës, presidentja e Kosovës, Osmani, ka thënë se udhëheqjen në dialog duhet ta marrin Shtetet e Bashkuara. Sipas bashkëbiseduesve të “REL”-it, vetëm trysnia e ShBA-së dhe BE-së mund të sjellë deri te një zgjidhje midis Kosovës dhe Serbisë. Në të kundërtën, Rusia, e cila vazhdon ta ketë shënjestër Ballkanin Perëndimor, mund të përfitojë nga kriza, thonë ato.

Pagat dhe kushtet e punës dekurajojnë policët

PRISHTINË, 15 TETOR - "Jo gjithmonë jemi të furnizuar me pajisje e uniforma të nevojshme... Paga që marrim është modeste, por gjithmonë duke shpresuar se një ditë do të jetë e dinjitetshme dhe do të ketë kushte më të mira pune".

Kështu një polic i Kosovës rrëfen për "Radion Evropa e Lirë" përvojën e tij mbi 10-vjeçare në policinë e shtetit. Thotë se shumë kolegë të tij detyrohen të kërkojnë edhe alternativa, si kredi, për t'i shkolluar fëmijët apo për t'i mbajtur familjet. Duke dashur të mbetet anonim, ai thotë se nuk e kupton përse institucionet e Kosovës nuk arrijnë t'i përmirësojnë kushtet e policëve - përgjegjësve kryesorë për sigurinë. Kjo çështje ishte temë debati këtë javë në Kuvendin e Kosovës, por pa ndonjë sukses.

Deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, nuk morën pjesë në seancën ku do të shqyrtohej projektrezoluta për mbështetjen financiare të Policisë së Kosovës, e cila u thirr nga partitë opozitare.

Dokumentet parashihet shtesa për policët në raste të rrezikshmërisë së lartë, pagesa për sigurim shëndetësor dhe Projektligjin për Pensionim të Parakohshëm - përfitime që aktualisht nuk ekzistojnë. Ai u hartua gati tri javë pas sulmit në Banjskë të Zveçanit, ku grupe të armatosura sulmuan Policinë e Kosovës, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Pagat e policëve të Kosovës nisin nga 210 euro në muaj për kadetët policorë dhe arrijnë në mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm. Polici në vendin tonë ka pagën 535 euro, ndërkaq polici i ri 472 euro.

Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri, thotë se policët e Kosovës punojnë në kushte të rënda, me paga të ulëta e pa sigurime shëndetësore. Atyrë që udhëtojnë nga një qytet në tjetrin nuk u paguhen as shujtat, as shpenzimet e udhëtimit, sipas tij. "Është jashtëzakonisht e pakuptimtë që nuk plotësohen kërkesat. Thënë në mënyrë figurative, është mbushur kupa", thotë Zeqiri për "Radion Evropa e Lirë". "Inatet politike e kanë vendosur policinë në mes dhe policia po pëson, sepse ajo është apolitike. Nuk merret policia me politikë, policia merret me autorizime ligjore, veprime konkrete, e kryen punën e vet jashtëzakonisht në mënyrë profesionale", shprehet ai.

Sipas të dhënave të sindikatës që udhëheq Zeqiri, 2 200 pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë larguar nga ky institucion prej se është themeluar në vitin 1999. "Mllef, pakënaqësitë kanë arritur kulmin. Me këtë pakënaqësi që po e shpreh policia me dorëheqje vullnetare, unë mendoj se dobësohet institucioni i sigurisë në vend", thotë Zeqiri.

Miloti - identiteti i vërtetë i të cilit



është i njohur për redaksinë e "Radios Evropa e Lirë" - kazhveshur uniformën e policit muaj më parë, për shkak të, siç thotë, pakënaqësive me kushtet e punës. "Çështja kryesore ishte paga, tani edhe kushtet e tjera të punës. Paga që unë kam marrë nuk më ka mjaftuar për gjëra elementare. Po të më mjaftonte unë kurrë nuk do ta merrja atë vendim pas një përvoje të mirë aty", thotë Miloti. Sipas tij, policëve nuk u paguhen kurrë orët shtesë të punës, por se në këmbim marrin ditë të lira pune.

Në këto ditë "policët që kanë viza, shkojnë jashtë shtetit për punë - një deri në dy javë ose më shumë",

thotë Miloti. "Kanë familjarë [në vende të BE-së], shkojnë dhe punojnë te të afërmit".

Për ish-drejtorin e Policisë së Kosovës, Reshat Maliqi, rritja e pagave të policëve është domosdoshmëri, ashtu si edhe përmirësimi i kushteve të punës. "Duhet që të zgjedhurit e popullit, njëherë e përgjithmonë, të mendojmë për këta policë, se vërtet punojnë në kushte të vështira, me rrezikshmëri tejet të lartë. Operacioni i fundit [në Banjskë të Zveçanit] besoj se i ka bindur të gjithë se me çfarë sfidash ballafaqohen ata gjatë punës së tyre", thotë Maliqi. "Unë e kam vajzën në polici... prej saj nuk

mund të pres asgjë që ta ndihmojë familjen. Mezi ia del për vete", shprehet ai.

Pagat e shërbyesve publikë, përfshirë policët, janë rritur në fillim të këtij viti përmes Ligjit të ri për Pagat. Atëkohë nga Sindikata e Policisë së Kosovës kanë thënë se me koeficientet e rinj për paga, qeveria ka bërë rritje minimale të pagës bazë - prej 20 deri në 60 eurosh për disa kategori brenda policisë, por për disa të tjera pagat janë ulur.

E formuar 24 vjet më parë, Policia e Kosovës numëron mbi 9 000 pjesëtarë me grada të ndryshme. Ata nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor.

KFOR-i përforcohet me pjesëtarë rumunë



PRISHTINË, 15 TETOR - NATO-ja ka bërë me dije se 130 trupa rumune kanë arritur në Kosovë në kuadër të misionit të saj në Kosovë, KFOR. Ditë më parë KFOR-i në Kosovë është përforcuar edhe me 200 ushtarë britanikë.

Aleanca veriatlantike ka thënë më 29 shtator se do ta rrisë praninë e saj në Kosovë përmes KFOR-it pas rritjes së tensioneve në veri të Kosovës.

Atëherë nuk e ka specifikuar numrin e saktë të trupave që do të dërgojë në Kosovë.

Vendimi i NATO-s vjen pas përshkallëzimit të situatës në veri të Kosovës më 24 shtator.

Atë ditë Polica e Kosovës është sulmuar në Banjskë të Zveçanit nga një grup i armatosur dhe, për pasojë, është vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Në shkëmbim e sipër të zjarrit në Banjskë janë vrarë edhe tre sulmues.

Kosova e ka fajësuar Serbinë për këtë sulm dhe ka paraqitur prova që, sipas saj, e vërtetojnë këtë pretendim, mirëpo Serbia i ka hedhur poshtë ato.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoičiqi, i cili ka hequr dorë nga të gjitha funksionet partiake.

Policia ia ka konfiskuar pronat e tij në Kosovë dhe kërkon ekstradimin nga Serbia.

Në Serbi ai është marrë në pyetje ditë më parë dhe është liruar brenda 24 orëve.

Misioni i NATO-s në Kosovë vepron në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ta garantuar sigurinë në këtë vend.

Deri më tani i ka pasur rreth 4 500 ushtarë në Kosovë të kombësive të ndryshme.

Personat e verbër kritikojnë qeverinë për fjalë boshe e mosrealizim të kërkesave

PRISHTINË, 15 TETOR - Në kuadër të fillimit të Javës Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë, është organizuar marshi përmes të cilit u është bërë thirrje institucioneve të krijojnë kushte më të mira infrastrukturore, duke filluar

me ndërtimin e pllakave taktile dhe sinjalizimin në stacione të autobusëve.

Marshi u organizua nga organizata "You Can Do", ku edhe janë shprehur pakënaqësi ndaj qeverisë për mosrealizimin e kërkesave ndaj personave të verbër.

Kryetari i organizatës "You Can Do", Jusuf Fazliu, tha se është bërë "boll" me fjalë boshe. Ai i bëri thirrje qeverisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe komunës së Prishtinës, që të ndërmarrin hapa për përmirësimin e kushteve për personat e verbër.



Kosova nënshkruan marrëveshje për projekte zhvillimore në vlerë prej 79 milionë eurosh

PRISHTINË, 15 TETOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se kanë nënshkruar marrëveshje për projekte zhvillimore në vlerë prej 79 milionë eurosh.

Ministri ka treguar se çfarë përfshijnë marrëveshjet. "Java që po lëmë pas ishte tejet e ngarkuar, por edhe mjaft produktive sepse nënshkruam marrëveshje

për projekte zhvillimore në vlerë prej 79 milionë euro, ku prej tyre: 61 milionë euro me KfW Gjermane për Parkun Solar 100 MW në KEK, ku 32 milionë euro prej tyre janë grant nga WBIF. 9 milionë euro grant me qeverinë Zvicerane për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në kompanitë rajonale të ujësjellësit. 9 milionë euro grant nga

fondet e BE-së me Bankën Botërore për përmirësimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes për tokat bujqësore në Rrafshin e Dukagjinit. Pra 50 milionë euro grante që nuk ka nevojë të kthehen, dhe 29 milionë euro kredi me kushte koncesionale. Qeveria për Zhvillim!", ka shkruar Murati në "Facebook".



Bie numri i të punësuarve në Kosovë në pjesën më të madhe të sektorëve

Prishtinë, 15 tetor - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka dalë me disa statistika të reja krahasuese për muajin korrik 2023 në raport me periudhën e njëjtë kohore të vitit të kaluar. Në muajin gusht të këtij viti numri i fluturimeve të realizuara ishte 1 315 apo 2.2 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 396 mijë e 100 ose 8.6 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për statistikën e transportit dhe telekomunikimit për muajin gusht 2023, thuhet se gjatë muajit gusht 2023 numri i udhëtarëve me tren ishte 5



530 ose 8.4 për qind më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Ndërkaq, në muajin gusht

2023, numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 milion e 619 mijë e 856 ose 3.3 për më pak se në

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 284 618 ose

5.7% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

ASK-ja, po ashtu, raporton se në muajin korrik 2023 indeksi i qarkullimit të shërbimeve kishte rritje më të madhe të këto grupe: Aktivitetet e Arkitekturës dhe Inxhinierisë (30.33 %) dhe agjencitë e udhëtimit (10.58 %), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (korrik 2022).

Në muajin korrik 2023 indeksi i numrit të të punësuarve kishte rritje të transporti dhe magazinimi për 0.84 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (korrik 2022), derisa kishte rënie në të gjithë sektorët e tjerë.

Shpenzimet e familjeve kosovare, çfarë tregojnë të dhënat?

PRISHTINË, 15 TETOR - Gjatë vitit 2022 familjet në Kosovë kanë shpenzuar mesatarisht nga mbi 8 100 euro për produkte ushqimore, arsim, shëndetësi, transport e shërbime të tjera. Të dhënat e publikuara në fund të shtatorit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës tregojnë se pjesa më e madhe e buxhetit familjar ndahet për blerjen e artikujve ushqimorë. Vitin e kaluar familjet kosovare kanë shpenzuar, mesatarisht, rreth 300 për qind më shumë para për ushqim sesa për banim.

Të paktën që nga viti 2003, familjet në Kosovë kanë shpenzuar më shumë para



për blerjen e produkteve ushqimore sesa për banim. Por, dallimi nuk ka qenë

asnjëherë më i madh se në vitin e kaluar. Të dhënat tregojnë se lloji i

artikujve ushqimorë që blihet - si drithëra, mish, vaj etj., nuk ka ndryshuar shumë ndër vite.

Përveç disa dallimeve të vogla, kosovarët kanë blerë produkte të ngjashme ndër vite. Buka, drithërat dhe mishi u kanë marrë pjesën më të madhe të buxhetit vjetor për ushqim.

Por, inflacioni dhe rritja e çmimeve të artikujve ushqimorë kanë bërë që, për herë të parë që nga së paku viti 2003, të shpenzohet më shumë se 50 për qind e buxhetit për blerje të artikujve ushqimorë.

Prej të gjithave kategorive të

specifikuara në raportin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, më së paku para janë shpenzuar për arsim.

Shpenzimet mesatare në vit për transport, veshmbathje dhe rekreacion janë rritur së fundi për familjet në Kosovë. Shpenzimet e tjera, si për arsim e shëndetësi, nuk kanë ndryshuar shumë.

Në shifrën e ulët të shpenzimeve për arsim ndikon fakti që shkollimi publik në vend është falas. Kjo bën që të mos ketë dallime të mëdha në shpenzime në mes të familjeve që jetojnë në zona rurale dhe atyre në zona urbane. /rel

Bëhen me pagesë qeset e plastikës në Kosovë, Shoqata e Konsumatorëve kundërshton vendimin

Prishtinë, 15 tetor - Qeset të cilat më herët merreshin falas, tani duhen paguar. Nëpër supermarketet e vendit tani këto qese duhen paguar 5 centë. Kundër vendimit të qeverisë, që qeset e plastikës

të mos jepen falas, ka dalë Shoqata e Konsumatorëve e Kosovës. "Këtë barrë të mbrojtjes së mjedisit nuk ka të drejtë askush t'ia ngarkojë vetëm qytetarit konsumator", ka thënë për Tëvë 1, Selatin

Kaçaniku nga kjo shoqatë. E për profesorin e mjedisit, Sami Makolli, çmimi 5 centë është i ulët për ta arritur efektin e largimit të qeseve të plastikës nga përdorimi. Ndërkohë, në Udhëzimin

Administrativ për qesen e plastikës, të miratuar nga Qeveria e Kosovës, qeset nga 25 deri në 50 micron do të kushtojnë 5 centë, ndërsa qeset nga 0 deri 25 micron janë ndaluar të përdoren.



Nga Jeruzalemi i zanafillës, tek Berlioni i Luftës së Ftohtë: qytetet që kanë bërë historinë e botës

Jeruzalemi, Athina, Roma, Konstandinopoja, Moska, Venecia, Firenze, Berlioni, dhe sot arisi, Londra e Nju Jorku. Një historian shpjegon rolin e jashtëzakonshëm që kanë patur në historinë e njerëzimit, qendrat e mëdha urbane

Që në agimin e kohëve, evolucioni i qendrave të mëdha urbane ka shoqëruar historinë e njerëzimit, duke shoqëruar herë pas here ngjitjen e këtij apo atij qytetërimi. Përgjatë shekujve, kanë marrë formë në këtë mënyrë disa "qytete simbole" që, në periudha të caktuara dhe në zona gjeografike të caktuara, janë afirmuar si qendra botërore, në gjendje të përfaqësojnë një epokë të tërë, apo më saktë "një botë" të tërë (duke alternuar periudha të mëdha shkëlqimi me periudha të mëdha rënieje). Këta "qytete-botë" kanë kaluar stafetën nga shekulli në shekull, deri në lindjen e metropoleve moderne, vende trazirash dhe kontradiktash të mëdha shoqërore (të pranishme edhe në shumë qytete të lashta). Për të kuptuar se çfarë ndërlidhesh kanë patur qendrat e mëdha urbane të historisë, cilët momente vendimtare kanë kaluar, çfarë trashëgimish kulturore kanë lënë pas dhe çfarë kontributi i kanë dhënë zhvillimit të qytetërimeve tona, Focus Storia Collection ka realizuar një intervistë me historianin Franco Cardini, i cili i ka dedikuar libra shumë prej këtyre qyteteve, nga Jeruzalemi në Samarkandë dhe nga Firenze në Stamboll.

Çfarë roli kanë luajtur qendrat e mëdha urbane, qysh në lashtësi?

Një rol shumë të rëndësishëm, duke qenë se zhvillimi i tyre ka përkruar me atë të çdo qytetërimi të madh. Vende takimi dhe përballjeje, fillimisht tregtare e më pas kulturore, qendrat e para të mëdha urbane, kanë qenë në fakt terren pjellor për format e para të organizimit shtetëror, të formimit të një sistemi organik të të jetuarit së bashku. Vetë fjala "qytetërim" (civilizim) buron jo më kot nga fjala latine civilis, term që i referohet fjalës civis, "qytetar".

Cilët ishin qytetet e parë të rëndësishëm që dolën në dritë?

Një ndër të parët ishte Xheriko, në Palestinë, gjurmët e të cilit shkojnë në mijëvjeçarin e X para Krishtit; më pas dolën qytetet siriane të Damaskut, më "i ri" me afro 1 mijë vjet, dhe Aleppos, i ngritur diku rreth mijëvjeçarit V para Krishtit; duke qëndruar tek qytetet e lashtë, mes mijëvjeçarit III dhe II para Krishtit i erdhin radha

Babilonisë, në zemër të Mesopotamisë, dhe Jeruzalemit, në Tokën e Shenjtë. Ndër këto, një prej më të rëndësishmeve ishte pikërisht Babilonia, një pikë referimi për shumë qytetërimë dhe qendër urbane e përmendur në shumë pasazhe të Biblës. Qyteti u bë model edhe për shkak të një karakteristike gjeografike, pra fakti që ngrihej në brigjet e një lumi të madh, Eufraatit. Në po të njëjtën mënyrë, shumë prej qendrave të mëdha urbane protagoniste të historisë njerëzore, e kanë të lidhur fatin e tyre me një burim të çmuar uji, siç do të bënte për shembull Roma me Teveren. Pas Babilonisë, duke mbetur tek qytetet më të lashta, ishte shumë me peshë roli që luajti Jeruzalemi.

Mbetemi tek Jeruzalmi. Cilët episode shënjuan historinë e tij, deri kur e bënë një objekt kontestimi mes hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve?

Si fillim, mund të kujtojmë se Jeruzalemi – tashmë me një histori mijëvjeçare – u shkatërrua nga themelet në vitin 135, me urdhër të perandorit Adrian (mbi rrënojat e vendbanimit të vjetër u ngrit kolonia e Aelia Capitolina), gjatë luftës së tretë judaike, momenti i radhës ky, në konfliktin ku ushtria e Urbes u gjend përballë rebelimeve hebraike që shpërthyen në Jude, kundër pushtimit romak (që në vitin 70 qyteti ishte rrënuar prej perandorit të ardhshëm, Titus). Skenë e kalvarit të Krishtit, Jeruzalemi u bë shumë shpejt një vend i shenjtë, duke u bërë sërish objekt përplasjeje që nga shekulli IV, mes pjesës hebraike dhe asaj të krishterë. Nga shekulli VII u bë objekt kontestimi edhe për myslimanët. Jeruzalemi u bë kështu një qytet unik në botë: vendi historik i Tempullit të Solomonit, e si pasojë pikë referimi për hebrenjtë, vend i vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit dhe në fund vendi i Muhamedit, profetit të myslimanëve, që u ngjit në qiell prej Haram esh-Sherif, ose Mali i Tempullit. Kalojmë pak tek Kryqëzatat, si ndryshoi qyteti gjatë "Mbretërisë së Jeruzalemit", lindur në 1099 pas kryqëzatës së parë në Tokën e Shenjtë. Jeruzalemi ishte kryeqyteti i i kësaj mbretërie të krishterë – që nuk zgjati as dy shekuj – mes 1099 dhe



dhe 1187, periudhë kur u ndërtuan apo restauruan shumë prej monumenteve të tij, edhe pse në tërësi, impianti urbanistik mbeti ai i përhershmi, i përqëndruar në bërthamën origjinale të njohur si "Qyteti i Vjetër". Për më tepër, eksperiencia e të ashtuquajturve shtete kryqëtarë krijoi një shans tjetër takimi kulturor, mes Europës dhe Lindjes.

Duke iu kthyer ndarjeve fetare, cili është vendi më i kontestuar historikisht në qytet?

Padyshim që vendi i xhamive në Malin e Tempullit (që mbahet prej të famshmit Mur të Lotëve, pjesë e një tempulli të lashtë hebre). E lëmë tani Tokën e Shenjtë, dhe zhvendosemi në Athinë, qytet që lulëzoi gjatë mijëvjeçarit I para Krishtit dhe më pas në Romë: cili ka qenë roli i tyre në zhvillimin e qytetërimit tonë? Mund të themi se Athina ishte vend i bukurisë, filozofisë, letërsisë dhe lirisë së ofruar nga demokracia, ndërkohë që Roma e shoqëroi emrin e saj me lavdinë, pushtetin dhe organizimin modern shtetëror. Kultura europiane përmbledhet në fakt, në një lojë vazhdimësie mes këtyre dy qyteteve dhe vetë Jeruzalemit, që është qendra ideale e fesë. Një dialektikë me tre, trashëgimia e të cilës është gjallë sot e kësaj dite.

Cili ka qenë roli i luajtur nga Konstandinopoja?

E ashtuquajtura "Roma e Re" – epitete që e mori pas rithemelimit të Bizantit të lashtë nga ana e Perandorit romak Konstantini I – u perceptua për shumë shekuj, si mbartësja e një lavdie të krahasueshme me atë të Romës. Kryeqytet i perandorisë bizantine dhe më pas asaj otomane, Konstandinopoja, Stambolli i sotëm, është qendër e vëmendjes së botës myslimane edhe sot e kësaj dite: sulltanët otomanë, me pushtimin e qytetit në vitin 1453 u ndjenë në fakt trashëgimtarë – për shkak të të drejtës së presë – të

vetë perandorisë romake.

Në krah të rëndësisë që ka fituar gjatë shekujve "Roma e Dytë", në qendër të shkëmbimeve kulturore dhe tregtare mes Lindjes dhe Perëndimit, duhet të përmendet edhe rëndësia e "Romës së Tretë".

Romës së Tretë?

Po, siç u quajt qyteti i Moskës pas pushtimit otoman të Konstandinopojës. Ishte Cari Ivani III, bashkëshort i një mbese të Konstantin XI Paleologut, pra perandorit të fundit bizantin, që i dha kryeqytetit rus rolin që kish qenë më parë i Urbes dhe më pas i vetë Konstandinopojës, duke e bërë Moskën një lloj trashëgimtareje spirituale të botës romako-bizantine. Pra, një Romë e Tretë. Duke mbetur tek tema e marrëdhënieve mes Lindjes dhe Perëndimit, a është korrekte ta quajmë Venecian, siç bëhet shpesh, "Porta e Orientit"?

Po: nga shekulli X, Venecia u vendos me vetëdije si ndërmjetëse mes Europës dhe Levantit, duke u sjellë më pas si trashëgimtare e perandorisë bizantine. Në brendësi të qytetit bëhej tregti me mallra të ardhur nga lindja, para se këto të shpërndaheshin në kontinent, dhe shumë prej tyre vinin pikërisht nga Konstandinopoja, qyteti që në vitin 1204, gjatë kryqëzatës së katërt, u sulmua nga vetë venecianët. Vetë ndërtimi i bazilikës së San Marcos u shoqërua nga perceptimi i ngritjes së një "Shën Sofie" të re, apo Hagia Sophia, emri i katedrales së famshme kristiane të Konstandinopojës, që më pas u bë xhami dhe në fund muzeum, prej të cilës u morën shumë pasuri që u vendosën në bazilikën veneciane. Shenjat e marrëdhënieve të Venecias me lindjen i gjen në shumë arkitektura të saj, dhe diçka të ngjashme e gjen edhe më poshtë në jug, në Palermo, qytet që përpara se të bëhej qendra e pasur dhe e mrekullueshme e Mbretërisë së Sicilisë, kish qenë zemra e Sicilisë islamike.

Duke mbetur në Itali, cila ka qenë rëndësia e Firences?

Qyteti toskan mori një rëndësi shumë të madhe mbi të gjitha mes shekujve XIV dhe XV, pra në kohën e familjes Medici, aq sa u bë djepi i Humanizmit dhe Rilindjes, duke u shndërruar në një lloj atdheu të artit dhe kulturës, në kalimin nga Mesjeta në modernitet.

Si ndryshuan qytetet e mëdha me revolucionin industrial dhe zhvillimin teknologjik të shekullit XX?

Me agimin e epokës industriale dhe transferimin relativ të shumë punëve nga fshati në qytet, u pa zhvillimi i metropoleve të mëdha si Londra, Parisi dhe nga ana tjetër e oqeanit, Nju Jorku, "Molla e Madhe". Vende të pasur me kontradikta sociale dhe diversitet relativ arkitektonik, kozmopolitë, kaotikë dhe të vrullshëm, ashtu si në të kaluarën kish qenë vetëm Roma e shekullit të parë, e cila mbeti një model referimi për çdo metropol. Nga Evropa në SHBA, duke kaluar tek fuqitë e sotme aziatike, çdo qytet i madh ia ka dalë të ruajë një origjinalitet të vetin dhe një kulturë të vetën.

Në disa raste, si për shembull në Jeruzalem, ka ndodhur që kultura me vlera të kundërta të kontestojnë të njëjtin qytet...

Po dhe në këto raste shpesh janë ngritur mure, siç ndodhi në kohën e Luftës së Ftohtë në Berlin, një prej djepeve parësore të kulturës moderne, kryeqytet i shkencës, teknologjisë dhe qytetërimit industrial që pas Luftës së Dytë, u vu në mes dy fuqive të mëdha: SHBA, Britania e Madhe e Franca nga njëra anë, dhe Bashkimi Sovjetik nga ana tjetër. Nga 1961 deri në 1989 u nda më dysh nga një mur i gjatë betoni, duke u bërë simboli i trishtë i Luftës së Ftohtë.

Duke ardhur në mijëvjeçarin e ri, cili metropol do e meritonte sot titullin qytet-botë?

Për t'u përgjigjur duhet të kthejmë sytë në Lindje: këtu, për nga fryma kozmopolite dhe moderne, do të thoja që titulli i shkon pa asnjë dyshim Shangait, megalopol i gjallë që është shprehje ekonomike dhe kulturore e fuqisë kineze në rritje, dhe në të njëjtën kohë, ka një karakter perëndimor. / Focus – Në shqip nga Bota.al

Nagorno-Karabak, konflikti i formësuar prej perandorive të së shkuarës



Një vendim fatal i Stalinit dhe ndarjet e shkaktuara nga Bashkimi Sovjetik, ende jehojnë në një konflikt historik që ka rishpërthyer së fundmi në fushëbetet e Kaukazit.

Kur Azerbajxhani nisi një ofensivë ushtarake në shtator për të rimarrë Nagorno-Karabakun, një rajon malor i Kaukazit Jugor, ai ndezi flakët e një mosmarrëveshjeje shekullore. Fitorja e Azerbajxhanit, e cila bëri që mijëra banorë etnikë armenë të largoheshin nga rajoni, ka të ngjarë të jetë e fundit në një seri betejash për enklavën, një çështje e formësuar në kohët moderne nga ngritja dhe rënia e Bashkimit Sovjetik.

Zyrtarisht, territori prej 2736 km katrore është pjesë e Azerbajxhanit dhe njihet me emrin rus, që përket "Karabaku malor". Por për armenët dhe popullsinë me shumicë armene të rajonit, ajo

njihet si Republika e Artsakh-ut ose Republika e Nagorno-Karabakh-ut, një shtet de facto i pavarur, i cili ka qenë jashtë sundimit të Azerbajxhanit që nga viti 1988.

Për shekuj me radhë, azerët myslimanë dhe armenët e krishterë, janë përleshur se kush duhet ta kontrollojë. Sundimi rus filloi në vitin 1823, dhe kur Perandoria Ruse u shpërbë në 1918, tensionet midis Armenisë së sapopavarësuar dhe Azerbajxhanit u rindezen. Tre vjet më vonë, Rusia e kontrolluar nga komunistët u vuri syrin shteteve të pavarura të rajonit të Kaukazit, dhe filloi t'i fuste në atë që do të bëhej Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike.

Në fillim u vendos që Karabaku të ishte pjesë e Republikës Sovjetike Socialiste Armene. Ky mendohet të ketë qenë një plan për të siguruar mbështetjen armene për sundimin sovjetik.

Por Stalini e ndryshoi vendimin. Në vitin 1923, Nagorno-Karabaku u bë rajon administrativ autonom brenda Azerbajxhanit, edhe pse 94 për qind e popullsisë ishte armene etnike. Armenët etnikë u ankuan se po u kufizoheshin autonomia dhe po diskriminoheshin prej Azerbajxhanit, por Bashkimi Sovjetik ishte intolerant ndaj nacionalizmit etnik dhe injoroi protestat kundër status quo-së. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, armenët etnikë të Nagorno-Karabakut bënë peticion për t'u bërë pjesë e Republikës së Armenisë. Azerbajxhani u përgjig duke u përpjekur t'i shtypte separatistët në vitin 1988, dhe përleshjet në rajon u intensifikuan. Në vitin 1991, si Azerbajxhani ashtu edhe Armenia shpallën pavarësinë nga BRSS dhe konflikti rajonal në Nagorno-Karabakh u shndërrua në luftë totale.



Si rezultat, më shumë se një milion njerëz u kthyen në refugjatë dhe rreth 30,000, përfshirë civilë, u vranë. Të dyja palët u përfshinë në spastrim etnik gjatë Luftës së Nagorno-Karabakut – Azerbajxhani kundër armenëve etnikë dhe forcat armene kundër azerëve etnikë. Pavarësisht shifrave humanitare brutale, negociatat midis palëve ndërpriteshin vazhdimisht.

Në vitin 1994, Armenia dhe Azerbajxhani firmosën Protokollin e Bishkek-ut, një armëpushim i ndërmjetësuar nga Rusia që ia la Nagorno-Karabakun Azerbajxhanit. Por megjithëse luftimet pushuan, palët nuk mundën të bien dakord për një traktat paqeje. Kufiri mes tyre u militarizua gjithnjë e më shumë dhe është quajtur një nga tre kufijtë më të militarizuar në botë.

Azerbajxhani mbështetet nga Turqia anëtare e NATO-s, ndërsa

Rusia ka mbështetur Armeninë, duke e bërë një zonë të mundshme konflikti. Ndërsa Nagorno-Karabaku është i vogël, interesat gjeopolitike janë të larta për shkak të afërsisë së tij me tubacionet strategjike të naftës dhe gazit dhe vendndodhjes midis forcave të fuqishme rajonale të Rusisë, Turqisë dhe Iranit.

Qeveria separatiste ka njoftuar se do të shpërbëhet deri në fund të vitit dhe Azerbajxhani ka premtuar të garantojë të drejtat armene në rajon. Por shumica e 120,000 armenëve etnikë të rajonit, nuk do të presin të zbulojnë nëse azerët do ta zbatojnë këtë premtim. "99.9 % preferojnë të largohen nga tokat tona historike," tha së fundmi David Babayan, këshilltar i presidentit të së vetëquajtur të Artsakhut. Ndërsa eksodi masiv vazhdon, historia e Nagorno-Karabakut duket se po i afrohet fundit. / bota.al



Kosova mund ta ketë një mundësi tjetër për kualifikim në "Euro 2024"

PRISHTINË, 15 TETOR - Kombëtarja e Kosovës në futboll e ka pasur një cikël kualifikues për t'u harruar sa më shpejt që të jetë e mundur. Aktualisht Kosova gjendet e katërta në Grupin I me vetëm shtatë pikë dhe nuk do të kualifikohet në "Euro 2024" përmes këtij cikli. Megjithatë, "Dardanët" mund ta kenë një rrugë tjetër për t'u kualifikuar në këtë Evropian, megjithatë asgjë nuk varet nga ta. 20 ekipe

kualifikohen në Evropian përmes ciklit kualifikues, ndërsa Gjermania shkon tutje si vend nikoqir. Ndërsa tri vendet e mbetura për Evropian do të përcaktohen nga Liga e Kombeve e sezonit 2022/23. Nga një ekip në secilën ligë: A, B dhe C do të kualifikohet në Kampionatin Evropian. Paraprakisht, katër fituesit e grupeve në secilën ligë kualifikohen në play-off. Në rast

se ekipi i parë i grupit e ka siguruar kualifikimin përmes ciklit kualifikues, atëherë në play-off shkon ekipi i radhitur më mirë në ligën përkatëse. Nga Liga C, Kosova gjendet në vendin e shtatë për arritjen e play-off-it, çfarë do të thotë se duhet të paktën tri ekipe para saj ta sigurojnë kualifikimin nëpërmjet ndeshjeve kualifikuese që janë duke u zhvilluar. Gjeorgjia, Greqia, Turqia,



Kazakistani, Luksemburgu dhe Azerbajxhani janë para Kosovës. Turqia aktualisht gjendet e para në grupin e saj në kualifikuese, ndërsa më afër kualifikimit janë Luksemburgu dhe Greqia. Në rast se këto tri kombëtare kualifikohen direkt, atëherë Kosova do të merrte pjesë në play-off-in e Ligës së Kombeve për ta siguruar kualifikimin historik në Kampionatin Evropian.

Laçi dhe Muçi: Tani duam vendin e parë në grup

TRANË, 15 TETOR - Qazim Laçi dhe Ernest Muçi kanë dalë para medieve në prag të ndeshjes miqësore me Bullgarinë, që do të zhvillohet nesër (e martë) në stadiumin "Air Albania" në orën 18:00. Të dy futbollistët e kanë vlerësuar maksimalisht kundërshtarin dhe u shprehën se kjo ndeshje për ta ka rëndësinë njëjtë si një sfidë kualifikuese. Qazim Laçi ka theksuar se është një mundësi e mirë për lojtarët që nuk kanë pasur shumë minuta në sfidat kualifikuese, teksa u ka bërë thirrje tifozëve për ta mbushur sërish stadiumin "Air Albania". "Jemi pak të çliruar sepse ishte një ndeshje shumë e rëndësishme për t'i marrë tre pikët dhe për të

krijuar shkëputje në pikë përkundrejt Polonisë dhe Çekisë. Ne jemi gjithmonë me këmbë në tokë. S'ka mbaruar gjë akoma. Kanë ngelur dhe dy ndeshje për t'u kualifikuar në Evropian. Objektivi i parë ishte kualifikimi në Evropian. Tani si objektivi i dytë kemi vendin e parë dhe për të do të luftojmë", ka thënë Laçi, duke treguar nëse do të ketë ndryshime në formacionin e Shqipërisë. "Besoj se trajneri Silvinjo i njeh të gjitha vlerat e lojtarëve. Jemi të gjithë të rëndësishëm për ekipin. Edhe ndeshje miqësore, edhe ndeshje kualifikuese, trajneri ka besim te të gjithë lojtarët. Jam



dakord me ju edhe për ne që nuk kemi shumë minuta me ekipin kombëtar është si një ndeshje zyrtare për ne, prandaj do ta marrim seriozisht", ka thënë Laçi. Më tutje, ai ka thënë se ka harmoni brenda kombëtares kuqezi: "Besoj se niveli i ekipit kombëtar është ngritur. Të gjithë

lojtarët janë në kampionatet më të mira në botë. Të gjithë japin maksimumin. Në çdo ndeshje kemi 11 lojtarë. Nuk mund të futësh më shumë. Zgjedhjet i bën trajneri. Të gjithë lojtarët kur vijnë në ekipin kombëtar janë të motivuar. Ndihejmi të gjithë krenarë dhe tani kemi një shans shumë të madh për t'i bërë ëndrrat e shqiptarëve dhe tonat realitet, kualifikimin në Evropian". Ndërsa Ernest Muçi ka thënë se të gjithë e kanë dashur shumë kualifikimin në Evropian që në fillim të kualifikueseve. Në lidhje me duelin me Bullgarinë, i riu tha se nuk e shohin si miqësore dhe

se duan ta vazhdojnë festën e nisur ndaj Çekisë. Edhe Muçi i ka ftuar tifozët të shkojnë në "Air Albania" dhe ta mbështesin skuadrën kuqezi. "Ftesa për tifozët për ndeshjen ndaj Bullgarisë? Shpresoj që shumë tifozë të vijnë dhe të na shikojnë. Ne do të japim më të mirën në këtë ndeshje, të vazhdojmë festën për fitoren me Çekinë. Tani duhet të fokusohemi te Bullgaria", ka thënë Muçi. Shqipëria është në vendin e parë në grup në kualifikimet për "Euro 2024". Kur kanë mbetur edhe dy ndeshje, kombëtares shqiptare i duhen edhe dy pikë për ta siguruar pjesëmarrjen në "Euro 2024" që zhvillohet në Gjermani.

Broja lë pas dëmtimin dhe kthehet në stërvitje me Chelsea



LONDËR, 15 TETOR - Armando Broja ishte lojtari që të gjithë e prisnin në grumbullimin e fundit të Shqipërisë, i konsideruar me të drejtë nga të gjithë si një lojtar që mund ta ndihmonte më tepër këtë grup për ta siguruar kualifikimin në Evropianin e vitit të ardhshëm. Megjithatë, 22-vjeçari është larguar nga grumbullimi i kuqezinjve vetëm dy ditë pasi kishte nisur për

shkak se sulmuesi nga Malësia e Madhe kishte një shqetësim në gju. Ekzaminimet kanë treguar se lëndimi nuk ishte serioz, diçka që konfirmohet edhe në këtë fundjavë, për shkak se futbollisti është bashkuar me grupin në seancën e fundit stërvitore të Chelseas. Broja do të jetë i gatshëm për sfidën e radhës që do ta kenë blutë e Londrës në fundjavë ndaj Arsenalit.

Broja vjen pas një dëmtimi që e ka mbajtur jashtë fushave të lojës për rreth 10 muaj e natyrisht frika e një tjetër dëmtimi është e madhe, por në të njëjtën kohë një situatë e tillë lë vend për teori të ndryshme. Broja nuk ishte në shkallët e "Air Albania" në ndeshjen me Çekinë, siç është parë Ardian Ismajli, i cili, gjithashtu, ishte i dëmtuar, por qëndroi pranë kuqezinjve.

Fatmirësisht, gjërat kanë shkuar mirë për Shqipërinë, e cila në këto kualifikuese ka shkëlqyer në plot kuptimin e fjalës pavarësisht prej mungesave apo dëmtimeve që ka pasur në këtë rrugëtim, por interesimi i lartë për Brojën nga tifozët e opinionin publik dhe ai largim pas vetëm dy ditësh grumbullim, nuk lë një shije dhe aq të mirë.

Granit Xhaka "rrit" ekonominë e Leverkusenit, fanella e tij më e shitura në klub

LEVERKUSEN, 15 TETOR - Asnjë fanellë e Leverkusenit nuk është shitur më shumë se ajo e Granit Xhakës. Xhaka e ka filluar në mënyrën më të mirë jetën e re në Gjermani. Një vështrim në shifrat e shitjeve të fanellave të Leverkusenit tani tregon se kapiteni i Zvicrës po bëhet lojtari i pëlqyer i tifozëve. Një listë e "ZDF Sport studio"

ka renditur se cila fanellë e secilit ekip të Bundesligës është shitur më shumë deri tani. Te Leverkuseni, fanella e Granit Xhakës me numrin 34 është më e shitura. Kjo do të thotë se fanella e Xhakës është më popullore se ajo e sulmuesit Victor Boniface, i cili tashmë ka shënuar shtatë gola në shtatë ndeshjet e para.

Ndërsa te skuadrat e tjera fanella e Harry Kanes është më e shitura, te Bayerni Xavi Simons është shumë i popullarizuar në RB Leipzig, kurse bluza e Leonardo Bonucci tek Union Berlini është më e kërkuara. Vetëm te Borussia Dortmund në krye është një fytyrë e njohur, Marco Reus.





Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (nenit 21), Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike (neni13), si dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SH.A, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.08.2023 mori vendim që të rishpallë:

KONKURS

Pozita e punës: Sekretar /e - i/e Bordit të Drejtorëve /Këshilltar/e - i Përgjithëm

Titulli i Mbikëqyrësit:/Raporton tek: Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: me afat të caktuar – tri (3) vite

Vendi: Prishtinë

Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Mirëmbanë regjistrin e aksionarëve të Ndërmarrjes;
- Vepron si agjent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;
- Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe /ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç kërkohet me ligj dhe aktet nënligjore;
- Kordinon me KE-në përgatitjen e shkresave (dokumente) për mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe shënon ato në librat e protokoleve;
- Pranon dhe distributon shkresat për Bordin e Drejtorëve;
- Ofron udhëzime juridike për Bordin e Drejtorëve;
- Kryen edhe punë tjera të kësaj fushe në bazë të kërkesës së Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes;
- I raporton Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale; Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
- Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve apo shkresave të ndryshme të punës së përditshme të ndërmarrjeve;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Konkursi është publikuar më datë 16 tetor 2023 dhe mbyllet më datë 30 tetor 2023.

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Të posedojë diplomë universitare në ligj dhe të plotësojë kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Pesë (5) vite përvojë pune profesionale;

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës (*Vërtetimi ose kontrata e punës*);
3. Dy rekomandime (*nëse keni*);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (*nëse ekzistojnë të tilla*);
5. Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;

6. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në pliko (zarfë) të mbyllur në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSIVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit. Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



NJOFTIM PËR KONTRATË (Furnizim)

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 23 048 121
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: Furnizim me module shtesë të lidhjes/paketimit të kartëmonedhave

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së , rr. "Garibaldi" nr. 33, 10000 Prishtinë.

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të lirë" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:
Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 24.10.2023 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 24.10.2023 ora 14:00

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Adresa: në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë;

Data: 27.10.2023, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: 1,000.00 € (një mijë euro) për periudhë valide prej 90 dite.

V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 27.10.2023, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33., Prishtinë.

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
www.bqk-kos.org



Zasnovano na br. zakona 03/L-087 o javnim preduzećima (član 21), Zakon br.04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br.03/L-87 o javnim preduzećima (član 13), kao i Administrativno uputstvo (MLSW) br.07/2017 o regulisanju postupka konkurencije u javnom sektoru, Upravnom odboru KRM "Pastrimi" SH.A, na sastanku održanom 31.08.2023. godine, odlučio je da ponovo objavi:

KONKURS

Radno mesto: Sekretar /e - upravnog odbora /savetnik / Generalni

Nadzorno zvanje: Izveštaji odboru direktora i izvršnom direktoru

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje ugovora: fiksni rok – tri (3) godine

Lokacija: Priština

Dužnosti i odgovornosti:

- Održavanje registra akcionara preduzeća;
- Deluje kao agent Društva za primanje obaveštenja;
- Izvršite sva arhiviranja, publikacije i/ili obelodanjivanja nadležnim organima u skladu sa zakonom i podzakonskim aktima;
- Koordinira sa EK da pripremi papire (dokumente) za sastanke Upravnog odbora i odbora za reviziju (osim ako to drugačije ne zahteva njihov predsedavajući), i obeležava ih u knjigama protokola;
- Prihvata i distribuira pisma Upravnom odboru;
- Daje pravne smernice Upravnom odboru;
- Obavlja druge radove u ovoj oblasti na zahtev Upravnog odbora i izvršnog direktora Preduzeća;
- Izveštaji Upravnom odboru i izvršnom direktoru Društva

Potrebne su veštine : (potrebne veštine i veštine za ovaj posao)

- Odlično profesionalno znanje; Poželjno znanje engleskog jezika;
- Poznavanje dobrih veština rada na računaru pomoću aplita programa (Microsoft Word, Excel, Power Point itd.) i Interneta;
- Sposobnost preispitivanja različitih predmeta ili papirologije svakodnevnog rada preduzeća;
- Istraživanje, analitičko, vrednovanje i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost održavanja kvaliteta rada čak i pod pritiskom.

Konkurs je objavljen 16 oktobra 2023 godine, a zatvoren je 30 oktobra 2023 godine.

Kvalifikacije za obrazovno, profesionalno i radno iskustvo: (kvalifikacije i iskustvo potrebno za ovaj posao)

- Da ima univerzitetsku diplomu iz prava i da ispunjava uslove kvalifikacije i profesionalne podobnosti iz člana 17 Zakona o javnim preduzećima;
- 5 (5) godina profesionalnog iskustva;

Prijava: Prijava mora da sadrži potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Dokaz o školskim kvalifikacijama;
2. Dokaz o radnom iskustvu (*dokaz o zaposlenju ili ugovoru*);
3. Dve (*ako imate*) preporuke.
4. Kopije poslednja dva uzastopna izveštaja o proceni rada (*ako takvi postoje*);

5. Identifikacioni dokument–fotokopiranu identifikacionu karticu;
6. Potvrde od suda da niste pod istragom.

REŽIM APLIKACIJE:

Prijavni formular se uzima i podnosi u zatvorenoj koverti u arhivi KRM "Pastrimi" SH.A, "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština.

Prijava poštom: Prijava kompletna sa dokumentima može se podneti i poštom na adresu: "Tahir Zajmi" St., br.5, Priština, 10000. Prijave poslate putem pošte treba da zadrže žig na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate putem pošte, koje nose poštansku marku na pošiljki izvršenoj poslednjeg dana isteka roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmotrene ukoliko stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu posle ovog roka i nekomplikovane uopšte neće biti razmatrane.

USLOVI UČEŠĆA NA KONKURSU:

Pravo na primenu imaju svi građani Republike Kosovo starosne dobi većine koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, poseduju neophodnu obrazovnu pripremu i stručnu sposobnost obavljanja zadataka i koji poseduju fizičke veštine potrebne za obavljanje odgovarajućeg položaja.

KRM "Pastrimi" AD nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muških i ženskih osoba iz svih zajednica na Kosovu.

UPOZORENJE:

PRIJAVE I NEKOMPATIBILNA DOKUMENTACIJA PREMA ZAHTEVIMA NAVEDENIM NA OVOM KONKURSU I ONIMA KOJI STIGNU PO ISTEKU ROKA KONKURSA NEĆE BITI RAZMATRANI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja. Za više informacija možete nas kontaktirati na br. Tel: +383 (0) 38 603 191



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

Nr. 1932/23
Datë: 16.10.2023

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2015 normativi për mësimdhëniesit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 01/2022, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS (ME KOHË TË PA CAKTUAR)

1. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për mësim klasor
Numri i Pozitave: 1

Në shkollë:

SHFMU "Mushnikova" në Gornje Selo (mësim në gjuhën boshnjake)

Kualifikimi i kërkuar:

- Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- Fakulteti i mësuesisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatit planet e lëndës në bazë vjetore, mujore, javore dhe ditore të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Mban orën mësimore sipas orarit të paracaktuar
- Planifikon, vëzhgon, mbikëqyr dhe udhëheq nxënëcin dhe sjelljen e secilit nxënësi,
- Zbaton metodologji të reja të mësimdhënies dhe vlerësimit,
- Kujdeset dhe ndjek zhvillimin profesional-trajnimet,
- Koordinon punën sipas kërkesave të administratës së shkollës;
- Organizon aktivitete jashtëshkollore;
- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e shkollës;
- Përgatit raportet e nevojshme, për nevojat e administratës së shkollës;
- Komunikon dhe bashkëpunon me prindërit dhe nxënësit e shkollës, kolegët dhe administratën;
- Bashkëpunon dhe merr pjesë në punën e organeve të shkollës, në organizimet e shkollës, dhe aktivitetet ekstrakurikulare;
- Kryen edhe punë të tjera të lidhura me aktivitetin mësimor të caktuara nga drejtori bazuar në legjisllacionin në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative.

Dokumentacioni i kërkuar:

(në kopje fizike)

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Diploma e Fakultetit (kopja e noterizuar)
- Nostifikimi, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Kosovës
- Referenca për rezultatet në punë (nëse posedon)
- Trajnimet profesionale
- Ekstrakti i lindjes

Dokumentet që do të kërkohen për kandidatët të cilët përzgjidhen

- Vërtetimi/dëshmia se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepër të padenjë që përfshinë fëmijët.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati/ja e sjell pas përzgjedhjes sipas procedurës.
- Të gjitha dokumentet origjinale kandidati/ja i/e përzgjedhur i sjellë për verifikim sipas procedurave.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë kalendarike nga data **17.10.2023** deri më **31.10.2023** që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit.
- Aplikimet e dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen.
- Aplikacioni për konkurim merrret në zyrat e DKA-së. Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjiten dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në DKA.
- VËMENDJE: Aplikimet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit për dorëzimin e aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga legjisllacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Prizrenit.

Drejtorja e Arsimit në Prizren
Drejtoresha/Luljeta Veselaj Gutaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Muhamet R. Humolli shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit B.I -N.T.P "M-R Com" me numër Unik Identifikues 810506222.

- Faton Morina B.I. N.SH. "Poliklinika Morina" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues 810485187.

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme " Ymer Prizreni "Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.

- AGRON PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesën 1-8 SHFMU "MUHARREM BEKTESHI".

- KENAN JONUZI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te larte "ARKITEKT SINANI".

- BEKIM PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

